




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Titull	Nr. Prot.
2-D/DPK	01-1447/13
Nr. Prot. (tjetër)	Data
02	20.05.2013
Nr. Pajisje	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 18.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-905/13 për ztr. *Dukagjin Dinaj* – *Ish Drejtori i Departamentit të trajnimeve dhe përkrahjes programore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (MPB)*, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion dhe nuk ka situatë të konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-905-13, për Zyrtarin e lartë, ztr. *Dukagjin Dinaj* – Drejtori i Departamentit të trajnimeve dhe përkrahjes programore (Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri), dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar i një veprimtarie private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-905/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. *Dinaj* i është dërguar njoftimi me një shkresë zyrtare nga Agjencia, pas të cilës ztr. *Dinaj* na ka kontaktuar dhe ka treguar se ai tashmë nuk ushtron funksion si zyrtar i lartë publik, sepse ka kaluar në detyra dhe angazhime tjera si i pavarur.

Kjo pastaj na është konfirmuar me shkresë zyrtare (DPKI-03-1135/13) që na ka dërguar zyrtari kontaktues nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, në të cilën pos tjerash shkruan se ish Drejtori i Departamentit të trajnimeve dhe përkrahjes programore, *Dukagjin Dinaj*, ka dhënë dorëheqje nga ky funksion publik, për të vazhduar me ushtrimin e funksionit si Noter.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

